

# POP

PERBALLJA  
OFERTAVE  
POLITIKE

NË MOS TI, **KUSH?**  
NË MOS SOT, **KUR?**

- **NGRIJE ZËRIN**  
NË ZGJEDHJET  
VENDORE! -



CSDC Gender Alliance for Development Center Qendra Aleanca Gjinore per Zhvillim V.Y.C. HIZI ER IRSH Lëvizja Rinore për demokraci TIOS Grupa e Zhvillim Korçë Hapa të Lehtë

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhjen. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "National Endowment for Democracy." Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra "Aleanca Gjinore pér Zhvillim", Tiranë;
- Qendra pér Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata pér Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore pér Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore pér Progres, Kukës;
- Rinia pér Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Pogradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizioni, Elbasan

# POP

PERBALLJA  
OFERTAVE  
POLITIKE

ZGJEDHJET VENDORE 14 MAJ 2023

KONTRATA SOCIALE



# SHKODËR

# KONTRATA SOCIALE 2023 – 2027

## BASHKIA SHKODËR

Përballja e Ofertave Politike (POP), është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare, të cilat punojnë në 12 bashki të Shqipërisë. Në bashkinë Shkodër, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj do të realizohet nga Intelektualët e Rinj Shpresë (IRSH) dhe Qendra "Hapa të Lehtë". IRSH punon për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri. Organizata përfaqëson intelektualë, të rinj dhe të reja, si edhe grupe të ndryshme nga organizatat e shoqërisë civile. "Hapa të Lehtë" është një organizatë që punon për të drejtat e njeriut, me fokus të veçantë të drejtat e grave.

Kontrata sociale hartohet nga POP në çdo fushatë elektorale gjatë Zgjedhjeve Vendore në Shqipëri. Hartimi i Kontratës Sociale bazohet në takime me qytetarë të grupeve të ndryshme dhe bazuar në një metodologji për të marrë mendimet dhe prioritetet e tyre.

Në hartimin e kontratës sociale 2023-2027 janë marrë parasysh kërkosat dhe nevojat e grupeve të ndryshme të qytetarëve brenda territorit të Bashkisë Shkodër, me një fokus të veçantë për grupet e cenesueshme. Kontrata sociale prezantonohet te të gjithë kandidatët për kryetar bashkie gjatë periudhës së fushatës elektorale.

## PRIORITETET KRYESORE

### Prioriteti 1. Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integrimit evropian në nivel vendor

- Krijimi i një strategjie të re në shpërndarjen e informacionit, kryesish për ato që lidhen ngushtësisht me interesat e qytetarëve dhe ndikimin e jetës së tyre (si: programet e ndryshme të nxitjes së punësimit, biznesit, strehimit etj).
- Faqe interneti – vijimi i përditësimit, me informacion lehtësisht të aksesueshëm, e përditësuar me të gjitha informacionet e nevojshme që nuk kanë nevojë për kërkosë.
- Fuqizimi i mekanizmave komunitar të përfaqësimit:
  - Këshilli Vendor i Rinisë dhe ndikimi i tij në politikat vendore për të rinjtë. Fuqizimi i Këshillave vendorë lokalë si mekanizëm konsultues dhe monitorues i politikave rimore.
  - Këshilli Vendor i Sigurisë Publike.

### Prioriteti 2. Drejtësia Sociale

- Promovimi i barazisë gjinore duke rritur përfaqësimin e grave në nivele drejtuese dhe duke zbatuar me korrektësi ligjin për barazinë gjinore në emërimin e nënkyetarëve dhe administratorëve.
- Rritja e vlerës së bonusit të qerasë për nënrat e divorcuara dhe me fëmijë; viktimat e dhunës në familje; nënrat vajza si edhe rritja e numrit të përfituesve.
- Krijimi i aplikacioneve në celular që promovojnë shërbimet e qendrave sociale dhe mundësive të aksesit të programeve që zbatojnë për rehabilitimin e viktimateve të dhunës në familje.

- Krijimi i aksesit në infrastrukturë për personat me aftësi të kufizuara përmes ndërtimit të rampave në hapësira publike, shkolla dhe qendra shëndetësore.
- Mirëfunkcionimi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në marrëdhëniet familjare dhe bashkërendimi i punës së autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin e viktimateve të dhunës në familje.

### Prioriteti 3. Forcimi dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor

- Promovimi i burimeve natyrore nëpërmjet nxitjes së biznesit dhe punësimit të të rinjve në zonat bregdetare dhe malore përmes krijimit të portaleve me profil ekonomik për shkëmbim informacioni dhe zhvillimin e programeve të përshtatura për këtë kategori.
- Nxitja e sipërmarrjes rimore nëpërmjet programeve që ofrojnë grante dhe stimuj fiskalë për sipërmarrësit e rinj në ngritjen e bizneseve të reja, me qëllim nxitjen e sipërmarrjes së të rinjve dhe mbështetjen e tyre.

### Prioriteti 4. Transport publik i aksesueshëm dhe i sigurtë për të gjithë qytetarët e Shkodrës.

- Përfundimi dhe vënia në funksion e terminalit të autobusëve në Bashkinë Shkodër. Restaurimi i stacioneve të autobusit ku të publikohet dhe respektohet orari. Rritja e frekuencës së lëvizjes së autobusëve si dhe shtimi i linjave që lidhin fshatrat me qytetin Shkodër.

### Prioriteti 5. Shkollat, kopshtet dhe çerdhet

- Funksionimi i sistemeve të ngrohjes në infrastrukturat shkollore duke garantuar lëndën e parë për vendosjen në punë të kaldajave pa kufizim.
  - Rregullimi i infrastrukturës arsimore në Njësitetë Administrative.
  - Krijimi i terreneve të reja sportive dhe restaurimi i këndeve sportive dhe palestrave të shkollave të qytetit për promovimin e sportit si stil i shëndetshëm jetese për të rinjtë dhe qytetarët.

### Prioriteti 6. Infrastruktura rrugore

- Mirëmbajtje e segmenteve rrugore të qytetit
- Përmirësim i ndriçimit dhe elementeve të sigurisë rrugore.
- Ndërtimi i rrugës së Dukagjinit sipas segmentit Prekal-Kir-Pult-Shalë

**Intelektualët e Rinj  
Shpresë**

Saimir Beqiraga

**Kandidat për Kryetar Bashkie,  
Partia Socialiste**

Benet Beci